

# **Stop goditjes! Ndalimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve**

**Pyetje dhe përgjigje  
për fëmijët dhe të rinjtë**



PUBLIKUAR MË 2009 NGA:

**“Nisma Globale për t’i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve”**

EDICIONI I RISHIKUAR I PUBLIKUAR MË 2017 NGA:

**“Nisma Globale për t’i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve”**

[www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)

“Nisma Globale për t’i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve” administrohet nga Shoqata për Mbrojtjen e të gjithë Fëmijëve, “APPROACH” Ltd, një shoqatë bamirëse e regjistruar me nr. 328132.

Zyra e regjistrimit: “Foundry, 17 Oval Way”, Londër SE11 5RR, MB.

### **Save the Children Suedi**

[www.raddabarnen.se](http://www.raddabarnen.se); [resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)

Save the Children Suedi është pjesë e Save the Children Association (Shoqata Save the Children), një fondacion ky që përbëhet prej 29 organizatave të ndryshme të Save the Children, të regjistruara në Zvicër dhe një prej organizatave më të mëdha për të drejtat e fëmijëve në botë. Save the Children Association është edhe pronar i Save the Children International (SCI), e cila është organizatë ndërkombëtare për implementimin e këtij programi.

Zyra kryesore e Save the Children Suedi: Rådä Barnen, SE-107 88 Stockholm, Landsvägen 39, Sundbyberg, Suedi.

Ky material/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mban plotësisht hartuesi. Qeveria e Suedisë nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim.

**K**ur përdoret ndëshkimi trupor ndaj fëmijëve, kjo është një shkelje e të drejtës njerëzore për të respektuar veten dhe trupin e tyre. Mirëpo, përkundër kësaj, ndëshkimi trupor është shumë i zakonshëm, dhe ligji në shumë shtete ende thotë që kjo është e pranueshme.

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe ligjet e tjera ndërkombëtare thonë që shtetet duhet të ndalojnë ndëshkimin trupor të fëmijëve, dhe gjithnjë e më shumë shtete po i ndryshojnë ligjet e tyre që përcaktojnë ndalimin e ndëshkimit trupor të fëmijëve.

Ekziston një listë e shteteve që tashmë kanë ndaluar plotësisht ndëshkimin trupor të fëmijëve në: [www.endcorporalpunishment.org/progress/prohibiting-states/](http://www.endcorporalpunishment.org/progress/prohibiting-states/).

Shpesh, njerëzit kanë shumë pyetje për ndalimin e ndëshkimit trupor të fëmijëve. Ky doracak ka për qëllim të ofrojë përgjigje në këto pyetje në atë mënyrë që të jenë të qasshme për fëmijët dhe të rinjtë. Është edhe një verzion i doracakut që dedikohet për të rriturit dhe një verzion që adreson pyetjet për ndëshkimin trupor në shkolla. Të dyja këto janë në dispozicion në [www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org) ose në [resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)



# Pyetjet

- 6 Çfarë është ndëshkimi trupor?
- 8 Fjalorthi - sqarimi i kuptimit të fjalëve
- 10 Çfarë është Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, dhe çfarë thotë ajo për ndëshkimin trupor të fëmijëve?
- 12 A dhemb me të vërtetë ndëshkimi trupor?
- 14 Shumica e të rriturve në vendin tim nuk duan që ndëshkimi trupor të jetë joligjor. A duhet t'i dëgjojmë ata, apo jo?
- 16 Disa të rritur thonë që goditja nuk u ka bërë ndonjë të keqe atyre kur kanë qenë fëmijë. A do të ishin ata të rritur të suksesshëm po qe se prindërit e tyre nuk do t'i ndëshkonin fizikisht si fëmijë?
- 17 Ka shumë gjëra më të këqija që u ndodhin fëmijëve – pse të fokusohemi aq shumë në goditjen?
- 18 Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin se si të i rrisin fëmijët e tyre. A duhet qeveria të ndërhyjë edhe atëherë madje kur fëmijët nuk janë duke u abuzuar?
- 21 Pse të mos u tregohet prindërve se si të i godasin fëmijët sigurt, në vend se të ndalohet goditja plotësisht?
- 22 Të rinjtë nganjëherë thonë që ndëshkimi trupor është në rregull. A nuk do të duhet që qeveria të i dëgjojë ata?
- 24 Disa të rritur mendojnë se ka dallim të madh në mes të rrahjes së një fëmije dhe një "goditjeje dashamirëse". A nuk është ndalimi i ndëshkimit trupor i tepërt?

- 26** Disa njerëz thonë që feja e tyre u thotë që të përdorin ndëshkim trupor. A është diskriminim ndalimi i tyre për ta bërë këtë ?
- 27** Në disa pjesë të botës, jeta është shumë e vështirë për shumë prindër, mësimdhënës dhe të tjerë që punojnë me fëmijë. A duhet të presë qeveria që gjërat të përmirësohen për ata të rritur para se të i ndalojë ata që të përdorin ndëshkimin trupor?
- 28** Pse duhet ta bëni ndëshkimin trupor joligjor? A nuk mund ti mësoni të rriturit që vetëm mos ta përdorin atë?
- 30** Ndëshkimi trupor i fëmijëve është shumë normal në kulturën time. Nëse bëhet joligjor, a është kjo e padrejtë për kulturën time?
- 33** Pse është aq e vështirë për të rriturit që të heqin dorë nga goditja e fëmijëve?
- 34** Nëse ndëshkimi trupor ndalohet, a do të përfundojnë fëmijët në laçrim dhe mos-disiplinë, pa respektim të askujt dhe të asgjëje?
- 35** A do të shpie ndalimi i ndëshkimit trupor në fëmijë që dënohen në mënyra edhe më të tmerrshme, si abuzim emocional, poshtërim ose mbyllje brenda?
- 37** A do të thotë ndalimi i ndëshkimit trupor se shumë prindër do të shkojnë në burg dhe do të i dërgojnë fëmijët e tyre në përkujdesje?
- 38** A është në rregull për prindërit që të godasin fëmijët e tyre për t'i ndaluar që të vetë-lëndohen?

# Fjalorthi

**Sulmi** Krimi i lëndimit të dikujt me qëllim.

**Ndalimi** Të thuhet që diçka nuk është e lejuar. Kur goditja e fëmijëve është 'e ndaluar' në një vend, askush në atë vend nuk lejohet të godasë fëmijët.

**Fushata** Përpjekja për të ndryshuar diçka që besoni se është e gabuar.

**Diskriminimi** Trajtimi i një personi ose grupi njerëzish më keq se sa të tjerët pa arsye të mirë. Për shembull, trajtimi i keq i njerëzve të një feje të caktuar ose trajtimi i të rinjve më keq se i të moshuarve.

**Mbrojtja e barabartë** Kur themi 'mbrojtje e barabartë', ne nënkuptojmë që fëmijët duhet të mbrohen nga të gjitha format e dhunës, po aq sa të rriturit. Për shembull, nëse është jo-ligjore goditja e një të rrituri, atëherë edhe goditja e një fëmije duhet të jetë jo-ligjore.

**Të drejtat e njeriut** Të drejtat themelore për të cilat njerëzit në mbarë botën pajtohen që secili i ka.

**Jo-ligjore ose e paligjshme** Kundër ligjit.

**Ligji** Një numër rregullash që u tregojnë njerëzve të një vendi për mënyrën se si të sillen.

**Ligjore ose e ligjshme** Të thuhet që diçka është 'ligjore' ose e 'ligjshme' në një vend nënkupton që ligji në atë vend e thotë që është në rregull.

**Integriteti fizik** Zotërimi dhe të qenit në kontroll të vetë trupit tuaj. Secili ka të drejtë për integritet fizik dhe të ndjehet se trupi i tij/saj është i sigurt prej të gjitha formave të dhunës.

**Disiplina pozitive** Një mënyrë pa dhunë dhe e respektueshme e rritjes dhe komunikimit me fëmijë, që inkurajon zhvillim dhe mësim të shëndetshëm.

**Parandalimi** Ndalimi i diçkaje para se të ndodhë.

**Ndalimi** Nëse ligji i një shteti thotë që nuk lejohet të bëni diçka.

**Mbrojtja** Mbrojtja sigurtë e diçka-je ose dikujt . 'Mbrojtja' e një fëmije nga dhuna nënkupton mbajtjen e tyre të sigurtë prej dhunës.

**Tradita ose tradicionale** Si janë bërë gjërat për një kohë të gjatë.

**Shkelja** Nëse të drejtat e njeriut i 'shkelen' dikujt, kjo nënkupton se të drejtat e tyre njerëzore nuk janë respektuar.

**Dhuna** Lëndimi i dikujt me qëllim.

# Çfarë është ndëshkimi trupor?

'Ndëshkimi trupor' nënkupton dënimin e dikujt duke përdorur forcë fizike në atë mënyrë që nënkupton lëndimin ose mundimin e tyre. Çdo dënim që përdor forcë është ndëshkim trupor, sado i lehtë që të jetë ai.

Për shembull, nëse një fëmijë e derdh pijen dhe prindi i tij/saj e godet në dorë për ta ndëshkuar, ky është ndëshkim trupor. Ndëshkimi trupor shpesh merr formën e goditjes ('qëllimit' ose 'shuplakës') ndaj fëmijëve. Mirëpo, mund të merr edhe forma të tjera (për shembull: goditja me këmbë e fëmijëve, shkundja e tyre ose detyrimi për të qëndruar në pozita të parehatshme). Nëse një fëmijë në shkollë nuk e di përgjigjen e një pyetjeje dhe një mësues e detyron që të qëndrojë në një këmbë për një kohë të gjatë, ky është ndëshkim trupor po ashtu.

Ekzistojnë edhe forma të tjera të ndëshkimit që nuk janë trupore, mirëpo të cilat janë po aq mizore – për shembull, frikësimi i qëllimshëm i fëmijëve ose vënia e tyre në siklet/turpërimi. Ky lloj ndëshkimi është shumë i parespektueshëm për fëmijët dhe është po aq i gabueshëm sa edhe ndëshkimi trupor. Ndëshkimi trupor i fëmijëve mund të ndodhë në vende të ndryshme – përfshirë shtëpinë, shkollën, vendet e tjera ku ofrohet kujdes për fëmijët dhe në burg ose vende të tjera ku mbahen fëmijët.

Të gjitha llojet e ndëshkimit mizor, përfshirë ndëshkimin trupor, janë të gabuara dhe duhet të ndalohen.





# Çfarë është Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, dhe çfarë thotë ajo për ndëshkimin trupor të fëmijëve?

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, ose KDF, paraqet listën më të plotë të të drejtave të fëmijëve që janë krijuar ndonjëherë. Ajo ka 54 nene apo pjesë që përshkruajnë të gjitha të drejtat që duhet të i kenë të gjithë fëmijët. 196 vende e kanë nënshkruar Konventën - më shumë se çdo konventë tjetër për të drejtat e njeriut.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës është përgjegjës për të siguruar që shtetet që kanë nënshkruar Konventën, në fakt edhe e vënë atë në praktikë. Komisioni ka qenë i qartë që, në mënyrë që shtetet të mbrojnë siç duhet të drejtat njerëzore të fëmijëve, një nga gjërat që duhet të bëjnë për të është të kenë ligje që ndalojnë të gjitha format e ndëshkimit trupor të fëmijëve.



# A dhemb me të vërtetë ndëshkimi trupor?

Po, natyrisht që dhemb! Të rriturit shpesh nuk e kuptojnë se ndëshkimi trupor lëndon nga 'jashtë' dhe nga 'brenda'.

Ndëshkimi trupor lëndon fizikisht dhe emocionalisht, dhe mund të jetë gjithashtu shumë poshtërues. Në mbarë botën tani po hulumtohet mbi ndjenjat dhe mendimet e fëmijëve për ndëshkim trupor. Në këtë hulumtim, fëmijët u tregojnë të rriturve se ai dhemb, madje shumë.

Pjesa më e madhe e hulumtimit është Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve.<sup>1</sup> Në vitin 2006, profesori Paulo Sérgio Pinheiro, i cili udhëheqi studimin, shkruan:

'Gjatë gjithë procesit të studimit, fëmijët vazhdimisht kanë shprehur nevojën urgjente për të ndaluar gjithë këtë dhunë. Fëmijët dëshmojnë për lëndimin - jo vetëm fizik, por edhe "lëndimin nga brenda" të cilin u'a shkakton kjo dhunë, kombinuar me pranimin e të rriturve, madje edhe miratimin e saj. Qeveritë duhet të pranojnë se kjo është me të vërtetë një urgjencë, megjithëse nuk është një urgjencë e re. Për shekuj me radhë, fëmijët kanë përjetuar dhunë në duart e të rriturve, të padukshëm dhe të padëgjuar. Por tani që shkalla dhe ndikimi i dhunës ndaj fëmijëve po bëhen të dukshme, ata nuk mund të mbahen më në pritje për mbrojtjen efektive për të cilën ata kanë një të drejtë të pakufizuar.'

1. Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën ndaj fëmijëve është një hulumtim i gjerë për dhunën ndaj fëmijëve në mbarë botën. Një ekip i OKB-së i ka pyetur shumë fëmijë, të rritur dhe organizata për dhunën ndaj fëmijëve në vendet e tyre. Për këtë studim mund të lexoni në këtë link: <http://www.unviolencestudy.org/>

Hulumtimet e tjera<sup>2</sup> për ndëshkimin trupor na tregojnë më shumë për mënyrën se si i dëmton ajo njerëzit. Për shembull, një studim i gjatë i botuar në vitin 2002 tregoi se fëmijët që ndëshkoheshin fizikisht nga prindërit kishin më shumë gjasa të kishin probleme të ndryshme - përfshirë agresivitetin dhe armiqësinë, vështirësitë në të mësuar rreth asaj çka është e drejtë dhe çka e gabuar, si dhe probleme të shëndetit mendor.

I gjithë ky hulumtim është i rëndësishëm. Por edhe po të mos kishte pasur hulumtime, ndëshkimi trupor do të ishte prapë i gabuar. Edhe nëse goditja e dikujt nuk shkakton dëme serioze afatgjate, ajo është prapë e gabuar. Ne e dimë se është e gabuar të goditen të rriturit - dhe fëmijët kanë po aq të drejtë për mbrojtje nga dhuna sikurse të rriturit.

2. Mund të lexoni më shumë për këto studime hulumtuese në versionin e këtij doracakut për të rritur, të cilën mund ta gjeni në Nismën Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve, [resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)

# Shumica e të rriturve në vendin tim nuk duan që ndëshkimi trupor të jetë jo-ligjor. A nuk duhet të i dëgjojmë ata?

Jo. Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga dhuna, edhe nëse jo të gjithë pajtohen për këtë.

Qeveritë duhet të sigurohen që të respektohen të drejtat e fëmijës. Politikanët duhet të bëjnë atë që është e drejtë dhe të marrin qëndrim mbi këtë çështje, edhe nëse shumica e të rriturve nuk pajtohen.

Në pothuajse të gjitha shtetet që e kanë ndaluar ndëshkimin trupor, shumica e të rriturve nuk janë pajtuar në fillim - por pasi u nxorr ligji, më shumë njerëz ndryshuan mendjen dhe filluan të mendojnë se ndëshkimi trupor ishte i gabuar. Pas pak vitesh, të rriturit do të rishikojnë të kaluarën e tyre dhe do të habiten - dhe turpërohen - që disa njerëz kanë menduar se goditja e fëmijëve ishte në rregull.

Gjithashtu, rezultatet e sondazheve për opinionet e njerëzve për ndëshkimin trupor nuk janë gjithmonë të besueshme, sepse përgjigjet që japin njerëzit mund të ndryshojnë, varësisht nga ajo se sa dinë njerëzit për këtë temë, dhe se si janë formuluar pyetjet.

**“Fëmijët kanë  
të drejtë të  
mbrohen nga  
dhuna, edhe  
nëse jo të  
gjithë pajtohen  
për këtë.”**



# Disa të rritur thonë që goditja nuk u ka bërë ndonjë të keqe atyre kur kanë qenë fëmijë. A do të ishin ata të rritur të suksesshëm po qe se prindërit e tyre nuk do t'i ndëshkonin fizikisht si fëmijë ?

Askush nuk e di se si të rriturit që janë goditur ose poshtëruar si fëmijë do të ishin sot nëse prindërit e tyre nuk do t'i kishin dënuar ata në këtë mënyrë.

Njerëzit që godasin fëmijët zakonisht e bëjnë këtë sepse ata janë goditur nga prindërit e tyre kur ishin fëmijë. Nuk ka asnjë arsye për të fajësuar njerëzit në të kaluarën për goditjen e fëmijëve, sepse ata thjeshtë po bënin atë që konsiderohej normale në atë kohë. Mirëpo, kohët ndryshojnë dhe tani e dimë se goditja e fëmijëve është e gabuar dhe mund të jetë shumë e dëmshme. Sot kuptojmë se fëmijët kanë të drejta si të gjithë të tjerët - dhe është koha për t'u siguruar që të gjitha të drejtat e tyre respektohen, duke përfshirë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna.

Disa njerëz thonë: 'Unë u godita si fëmijë dhe tani jam në rregull.' Por, ka njerëz që kanë përjetuar përvoja të ndryshme të këqija derisa janë rritur dhe 'tani janë në rregull' si të rritur - dhe askush nuk do të thoshte që ajo çka ata kanë përjetuar ka qenë në rregull. Shpesh, mënyra se si ata i kanë përballuar përvojat e tyre dhe e kanë ndryshuar jetën e tyre i ka ndihmuar që të jenë 'në rregull', jo vetë përvojat që kanë pasur.



# **Ka shumë gjëra më të këqija që u ndodhin fëmijëve - pse të fokusohemi aq shumë në goditjen?**

“Disiplina” e dhunshme është forma më e zakonshme e dhunës ndaj fëmijëve.<sup>3</sup> Mijëra fëmijë - kryesisht fëmijë shumë të vegjël - në mbarë botën vriten nga ndëshkimi trupor çdo vit dhe miliona të tjerë lëndohen. Goditja e fëmijëve u mëson atyre të pranojnë dhunën dhe kjo mund t'i bëjë ata që të sillen me agresivitet ose dhunshëm në të ardhmen.

Kur ligji u lejon të rriturve që të godasin fëmijët, kjo tregon se shoqëria i sheh fëmijët si pronë, më pak të rëndësishëm se sa njerëzit, në vend që ti shohin si mbajtës të të drejtave të plota. Ndalimi i ndëshkimit trupor tregon se shoqëria mendon se fëmijët janë të rëndësishëm dhe ka një efekt pozitiv në mënyrën se si shikohen dhe trajtohen ata. Asnjë shtet nuk mund të pretendojë se respekton të drejtat njerëzore të fëmijëve, as të pretendojë se ka një sistem të sigurtë për mbrojtjen e fëmijëve, derisa ligji i atij shteti e lejon dhunën ndaj tyre.

3. UNICEF (2014), Hidden in Plain Sight: A statistical analysis of violence against children, NY: UNICEF

# **Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin se si të rrisin fëmijët e tyre. A duhet qeveria të ndërhyjë edhe atëherë madje kur fëmijët nuk abuzohen?**

Prindërit nuk i kanë pronë fëmijët e tyre – fëmijët janë njerëz me të drejta të tyre.

Këto të drejta duhet të respektohen kudo, duke përfshirë edhe shtëpinë. Secili në një familje ka të drejtë të barabartë për mbrojtje nga dhuna, sado i ri apo i vjetër të jetë. Ashtu si të rriturit në një familje që nuk duhet të godasin njëri-tjetrin, të rriturit nuk duhet të godasin as fëmijët - dhe ligji duhet të thotë kështu.

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës thotë se familjet janë shumë të rëndësishme. Ajo thotë se prindërit kanë një përgjegjësi për t'u kujdesur për fëmijët dhe për të siguruar që ata veprojnë në interesin e tyre më të mirë.

Disa njerëz thonë se t'i godasësh fëmijët si dënim është gjë e mirë për ta. Por, Komisioni për të Drejtat e Fëmijës ka thënë se ndëshkimi trupor kurrë nuk është i mirë për fëmijët, dhe kjo mbështetet nga rezultate të shumta të hulumtimeve. Është në interesin më të mirë të fëmijës për t'u mbrojtur plotësisht nga të gjitha format e dhunës, duke përfshirë edhe ndëshkimin trupor.



**“Prindërit  
nuk i kanë  
pronë fëmijët  
e tyre.”**

**“Nuk ka  
gjë të tillë  
si të  
goditur**

**“të sigurtë.”**



# Pse të mos u tregohet prindërve se si t'i godasin fëmijët në mënyrë të sigurtë, në vend se të ndalohet goditja plotësisht?

Nuk ka gjë të tillë si të goditur 'të sigurtë'. Të gjithë ata që godasin fëmijët tregojnë mosrespektim të fëmijëve dhe shkelin të drejtën e tyre për respektimin dhe kontrollin e trupit të tyre.

Shumë kërkime kanë treguar se dënimi 'i butë' trupor mund të çojë në një dhunë më serioze ndaj fëmijëve. Hulumtimet kanë treguar gjithashtu se të rriturit e kanë të vështirë të gjykojnë me saktësi sa shumë i godasin fëmijët. (Shih "A dhemb me të vërtetë ndëshkimi trupor?" në faqen 12).

Disa shtete janë përpjekur të bëjnë ligje që përcaktojnë mënyra të pranueshme për të goditur fëmijët, për shembull duke thënë se vetëm fëmijët e një moshe ose gjinie të caktuar mund të goditen ose që fëmijët mund të goditen vetëm në disa mënyra. Kjo është një gjë e padrejtë dhe e keqe për të bërë. Njerëzit kurrë nuk do të thonë se disa forma të dhunës kundër grave, apo kundër të moshuarve, janë në rregull. Natyrisht, të gjitha format e dhunës ndaj këtyre grupeve dhe grupeve të tjera duhet të jenë kundër ligjit. Është po aq e gabuar të themi se disa forma të dhunës kundër fëmijëve janë në rregull. Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga sulmet. Për më shumë, fëmijët, të cilët në përgjithësi janë më të vegjël dhe më pak të fortë se të rriturit, kanë të drejtën për më shumë mbrojtje.

# Të rinjtë nganjëherë thonë që ndëshkimi trupor është në rregull. A nuk duhet qeveria që t'i dëgjoj ata?

Të rriturit duhet gjithmonë të dëgjojnë atë që thonë fëmijët, dhe gjithashtu duhet të përpiqen t'i kuptojnë fëmijët.

Mund të ketë shumë arsye pse një fëmijë duket që e mbështet përdorimin e ndëshkimit trupor. Për shembull, fëmijët shpesh nuk duan të mendojnë se prindërit e tyre do t'i lëndojnë ata pa ndonjë arsye. Apo ndoshta të gjithë rreth tyre mendojnë se ndëshkimi trupor është i mirë, dhe kështu ata mendojnë se është normale. Mund të jetë e vështirë të mendosh ndryshe dhe të sfidosh idetë për të cilat pajtohen të gjithë të tjerët, veçanërisht kur fëmijët nuk janë në dijeni për të drejtat e tyre si njeri.

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të respektohen dhe të jenë të sigurt nga dhuna. Fëmijët kudo kanë nevojë për mbrojtje nga dhuna po aq sa, madje edhe më shumë, se sa të rriturit.

Në këtë doracak, ne kemi thënë tashmë se përmes hulumtimeve shumë fëmijë u kanë treguar të rriturve se sa i lëndon ndëshkimi trupor ata, si fizikisht ashtu edhe emocionalisht (shih "A dhemb me të vërtetë ndëshkimi trupor?" në faqe 12).

Shumë fëmijë dhe të rinj mendojnë se ndëshkimi trupor duhet të ndalohej. Në shumë vende, fëmijët po bëjnë fushatë bashkë me të rriturit për mbrojtje të barabartë nga dhuna.



# Disa të rritur mendojnë se ka dallim të madh në mes të rrahjes së një fëmije dhe një 'goditjeje dashamirëse'. A nuk është ndalimi i ndëshkimit trupor i tepërt?

Rrahja e ashpër e një fëmije mund ta lëndojë atë fizikisht më shumë sesa që njerëzit e quajnë 'goditje dashamirëse', por ato të dyja janë të dhunshme dhe të dyja i shkelin të drejtat njerëzore të fëmijës.

Kur të rriturit e quajnë ndëshkimin trupor një 'goditje dashamirëse' ose një 'goditje e lehtë e dashur', ata përpiqen të shpjegojnë atë që ata e shohin si dallim në mes të të qenurit mizor ndaj një fëmije dhe ndëshkimit të një fëmije, sepse i duan ata dhe e dëshirojnë më të mirën për ta. Ata besojnë se 'goditja e lehtë e dashur' nuk është aq e ashpër sa për ta lënduar rëndë një fëmijë.

Sidoqoftë, kur njerëzit bëjnë fushatë për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave apo ndaj të moshuarve, nuk thonë se duhet të lejohet 'goditja dashamirëse' - thonë se çdo dhunë ndaj grave dhe të moshuarve është e gabuar. Pra, pse duhet të jetë ndryshe për fëmijët? Dhe thënia 'goditje dashamirëse' është në të vërtetë shumë e paqartë, pasi që pavarësisht se a e bën të tingëllojë në rregull, goditja e njerëzve nuk është sjellje dashamirëse.



Disa njerëz gjithashtu thonë se ekziston një dallim i madh në mes të abuzimit të fëmijëve dhe një 'goditjeje të lehtë' - domethënë, nëse një fëmijë nuk goditet shumë, është më pak serioze. Por, edhe nëse fëmija goditet lehtë, kjo prapë shkel të drejtat e tyre për t'u trajtuar me respekt dhe për të pasur kontroll mbi trupin e tyre. Ka shumë mënyra më pozitive për të ndihmuar fëmijët që të mësojnë, të cilat nuk përfshijnë dënim të dhunshëm.

Ligjvënësit dhe qeveritë tradicionalisht kanë thënë se 'abuzimi i fëmijëve' dhe 'ndëshkimi trupor' janë gjëra të ndryshme. Por, shumica e abuzimeve ndodhin kur një i rritur e ndëshkon një fëmijë. Është e pasaktë që kjo të lë të kuptohet se ato janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Për të mbrojtur fëmijët dhe për të respektuar të drejtat e tyre, çdo lloj dhune ndaj tyre duhet të jetë e paligjshme.

# Disa njerëz thonë që feja e tyre u thotë që të përdorin ndëshkim trupor. A është diskriminim ndalimi i tyre për ta bërë këtë?

Jo. Njerëzit kanë të drejtë të praktikojnë fenë e tyre – por megjithatë, ata duhet t'i respektojnë të drejtat e të tjerëve.

Është e vërtetë se disa njerëz besojnë se feja e tyre u thotë që të ndëshkojnë fizikisht fëmijët e tyre. Megjithatë, kjo nuk u jep atyre të drejtën për të përdorur ndëshkimin trupor. Njerëzit kanë të drejtë të praktikojnë fenë e tyre - por vetëm për aq sa nuk shkelin të drejtat e njerëzve të tjerë. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje nga dhuna, pa marrë parasysh se çfarë feje ndjekin ata ose prindërit e tyre.

Goditja e fëmijëve është kundër vlerave dhe besimeve të feve kryesore në botë, të cilat mësojnë për mëshirë, barazi, drejtësi dhe jo dhunë. Udhëheqësit fetarë janë pjesë e lëvizjes globale për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve. Në vitin 2006, në Asamblenë Botërore të Feve për Paqe në Japoni, më shumë se 800 udhëheqës fetarë nga shumë fe kanë mbështetur 'një angazhim fetar për të luftuar dhunën ndaj fëmijëve.'<sup>4</sup>

4. Për më shumë informata, vizitoni [www.churchesfornon-violence.org](http://www.churchesfornon-violence.org).

# **Në disa pjesë të botës, jeta është shumë e vështirë për shumë prindër, mësimitdhënës dhe të tjerët që punojnë me fëmijët. A duhet të presë qeveria që gjërat të përmirësohen për ata të rritur para se t'i ndalojë ata që të përdorin ndëshkimin trupor ?**

Jo. Fëmijët nuk duhet të presin për mbrojtje nga dhuna - ata kanë nevojë për këtë tani.

Kjo pyetje tregon diçka që shumica e njerëzve tashmë e dinë - shpesh, të rriturit i godasin fëmijët për të lehtësuar stresin ose zemërimin e tyre, dhe jo për t'i mësuar fëmijët se si të sillen. Është e vërtetë që shumë të rritur në mbarë botën kanë jetë të vështirë dhe probleme të mëdha - por nuk duhet t'i shfryjnë këto probleme tek fëmijët.

Të rriturit që e humbin durimin dhe i godasin fëmijët shpesh ndjehen shumë fajtorë më pas. Në një afat të gjatë kohor, ndalimi i ndëshkimit trupor dhe përdorimi i disiplinës pozitive e bën jetën shumë më pak stresuese për të gjithë - si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit.

# **Pse duhet ta bëni ndëshkimin trupor joligjor? A mund t'i mësoni të rriturit që mos ta përdorin atë?**

Nëse të rriturve u jepen udhëzime se është më mirë të ndalojnë së godituri fëmijët, por ligji ende thotë se kjo është në rregull, është shumë konfuze për të gjithë dhe shumë të rritur do të vazhdojnë të godasin fëmijët.

Ligji duhet të thotë qartë se goditja e fëmijëve është e gabuar dhe nuk është më e pranueshme. Kjo do të dërgojë një mesazh të qartë për të gjithë. Pastaj, në të njëjtën kohë me ndryshimin e ligjit, qeveritë dhe organizatat e tjera duhet t'i mësojnë të rriturve mënyrat pozitive të rritjes/ edukimit të fëmijëve.



# **Ndëshkimi trupor i fëmijëve është shumë normal në kulturën time. Nëse bëhet joligjor, a është kjo e padrejtë për kulturën time?**

Ka shumë gjëra për të qenë krenarë në secilën kulturë, por goditja e fëmijëve nuk paraqet asnjërën prej tyre!

Historikisht, tradita e goditjes së fëmijëve ndoshta vjen kryesisht nga kulturat e evropianëve të bardhë. Njerëzit nga Evropa janë vendosur në shtete të tjera dhe kanë sjellë idenë e ndëshkimit trupor bashkë me ta. Sot, shoqëritë e vetme ku fëmijët kurrë nuk ndëshkohen fizikisht janë shoqëritë e vogla, gjahtar-kërkuese.

Ndëshkimi trupor përdoret në shumicën e kulturave dhe të gjitha kulturat duhet ta mohojnë atë, ashtu siç kanë mohuar shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut, të cilat ishin tradicionale për ta. Kulturat mund të ndryshojnë dhe njerëzit mund të zgjedhin se si duan të jetë shoqëria e tyre. Tani ka lëvizje për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve në të gjitha kontinentet e botës, dhe ndëshkimi trupor në shkolla dhe burgje është bërë i paligjshëm në shumë shtete në mbarë botën.<sup>5</sup>

Nuk ka rëndësi se prej nga vjen fëmija, sa vjeç është apo çfarë feje praktikon - të gjithë fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna. Kultura dhe tradita nuk mund të përdoren si arsye për dhunën ndaj fëmijëve.

5. Shihni listën e vendeve në <http://www.endcorporalpunishment.org/progress/legality-tables/global-table.html>



**“Prindërit mund  
të vendosin  
për edukimin  
e fëmijëve  
të tyre  
pa dhunë.”**



# Pse është aq e vështirë për të rriturit që të heqin dorë nga goditja e fëmijëve?

Është e vërtetë se shumë të rritur, përfshirë politikanët, e konsiderojnë idenë e ndalimit të ndëshkimit trupor si shumë të vështirë. Po të mos ishte kështu, fëmijët tashmë do të kishin të njëjtën mbrojtje nga dhuna sikurse të rriturit.

Ekzistojnë disa arsye të ndryshme pse të rriturve u duket e vështirë heqja dorë nga goditja e fëmijëve:

- 1. Përvoja personale.** Shumica e të rriturve janë goditur nga prindërit e tyre kur ishin fëmijë, dhe shumica e prindërve i kanë goditur fëmijët e tyre. Askujt nuk i pëlqen të mendojë gjëra të këqija për prindërit e tyre ose për mënyrën se si i rrisin fëmijët e tyre. Kjo e bën të vështirë për shumë njerëz që ta pranojnë se ndëshkimi trupor është një gjë e keqe. Nuk ka asnjë arsye për të fajësuar prindërit që kanë përdorur ndëshkimin trupor në të kaluarën - zakonisht ata thjeshtë kanë bërë atë që mendonin se ishte normale. Por, tani është koha për të ecur përpara!
- 2. Të rriturit shpesh qëllojnë fëmijët sepse janë të zemëruar ose të stresuar.** Kur e bëjnë këtë, mund të bëhet shprehi - kështuqë kur i rrituri mendon se fëmija po sillet keq, ata automatikisht i godasin. Është e vështirë të ndryshohen shprehitë si kjo - por është e mundur. Prindërit mund të vendosin për edukimin e fëmijëve të tyre pa dhunë. Qeveritë dhe organizatat e tjera, si bamirësitë dhe organizatat fetare, mund t'i ndihmojnë prindërit ta bëjnë këtë.
- 3. Nganjëherë të rriturit nuk e dinë se ka mënyra të tjera për t'i mësuar fëmijët.** Qeveritë dhe organizatat e tjera mund të ndihmojnë në mësimin e të rriturve në lidhje me disiplinën pozitive në mënyrë që ata të mund të jetojnë bashkë me fëmijët dhe të kenë marrëdhënie pozitive dhe jo të dhunshme.

# Nëse ndëshkimi trupor ndalohet, a do të përfundojnë fëmijët në lazdrim dhe mos-disiplinë, pa respektim të askujt dhe të asgjëje?

Jo! Fëmijët mund të mësojnë pa dënime të dhunshme, nëpërmjet të kuptuarit, respektit dhe tolerancës.

Ndëshkimi trupor i mëson fëmijët që përdorimi i dhunës është një mënyrë e mirë për zgjidhjen e problemeve dhe që është në rregull përdorimi i dhunës ndaj njerëzve që janë më të vegjël ose më të rinj se ju. Ndëshkimi trupor mund të nënkuptojë që fëmijët frikësohen për të treguar 'respekt' për më të moshuarit - megjithatë kjo nuk është e njëjtë me të kuptuarit e vërtetë se cili është respekti i ndërsjellë. Në fakt, shumë hulumtime kanë dëshmuar se ndëshkimi trupor është i lidhur me fëmijët që janë më agresivë, duke pasur marrëdhënie të vështira dhe duke treguar më pak respekt për të tjerët kur rriten.



Qeveritë duhet të mbështesin të qenurit prindër pozitivë dhe të ndihmojnë të rriturit të mësojnë për disiplinën pozitive dhe edukimin pa dhunë. Disiplina pozitive nuk i llaston fëmijët - i ndihmon ata të mësojnë të mendojnë se si sjellja e tyre i prek njerëzit e tjerë. Ka shumë materiale që mund të përkthehen dhe pastaj të përdoren për të ndihmuar prindërit në secilin vend.

# A do të shpie ndalimi i ndëshkimit trupor në fëmijë që dënohen në mënyra edhe më të tmerrshme, si abuzim emocional, poshtërim ose mbyllje brenda?

Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga TË GJITHA format e dënimeve dhe trajtimeve mizore.

Sikurse ndëshkimi trupor, kjo përfshinë abuzimin emocional dhe poshtërimin (për shembull, mërzitja ose turpërimi i qëllimshëm i një fëmije). Përveç ndalimit të ndëshkimit trupor, qeveritë duhet t'i ndihmojnë edhe prindërit që të mësojnë për mënyrat pozitive dhe jo të dhunshme të rritjes/edukimit të fëmijëve.

Prindërit që godasin fëmijët e tyre zakonisht nuk ndjehen mirë për këtë - shpesh ndihen të mërzitur dhe fajtorë. Shumica e tyre dëshirojnë të kenë këshilla se si të zgjidhin problemet me fëmijët e tyre. Mbështetja e prindërve për të përdorur qasjen pozitive i ndihmon ata që të zgjidhin konfliktet me fëmijët e tyre pa dhunë apo keqtrajtim. Kjo e bën jetën familjare më të mirë për të gjithë.



# A do të thotë ndalimi i ndëshkimit trupor se shumë prindër do të shkojnë në burg dhe do t'i çojnë fëmijët e tyre në përkujdesje?

Jo. Ne nuk duam ta ndryshojmë ligjin sa për të ndëshkuar shumë prindër.

Ndalimi i ndëshkimit trupor nuk ka të bëjë me ndëshkimin e prindërve - ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve dhe me qëllimin për t'u treguar të gjithëve se përdorimi i dënimit të dhunshëm nuk është më në rregull.

Fëmijët duhet vetëm të distancohen nga prindërit e tyre nëse janë në rrezik të lëndohen rëndë. Nëse jo, familjes duhet t'i ofrohet përkrahje dhe edukim.

Në disa shtete, të gjitha format e ndëshkimit trupor tashmë janë të ndaluara. Nuk ka dëshmi nga këto vende se shumë më tepër prindër janë dërguar në burg. Rastet e dhunës midis dy të rriturve zakonisht shkojnë vetëm në gjykatë, nëse dhuna është mjaft serioze, dhe kjo do të vlente njësoj për dhunën midis një të rrituri dhe një fëmije.

Por, ndryshimi i ligjit do ta bënte më të lehtë ndëshkimin e prindërve dhe të të rriturve të tjerë, të cilët i lëndojnë fëmijët rëndë. Kjo gjithashtu nënkupton se shumë përpjekje bëhen për të mbështetur dhe edukuar prindërit në radhë të parë për të parandaluar përkeqësimin e situatës.

# A është në rregull për prindërit që të godasin fëmijët e tyre për t'i ndaluar që të vetë-lëndohen?

Goditja e një fëmije nuk është e njëjtë me mbrojtjen e tyre!

Prindërit duhet t'i mbrojnë fëmijët - sidomos foshnjat dhe fëmijët e vegjël - gjatë gjithë kohës. Kjo është një pjesë normale e të qenit prind. Nëse një fëmijë i afrohet zjarrit ose ecën në një rrugë të rrezikshme, sigurisht që prindërit e tyre do të duhet t'i ndalojnë - duke i mbajtur mbrapa, duke i kapur, ose duke u treguar atyre për rrezikun. Por, goditja nuk i mëson ata se duhet të kujdesen për veten, ose se prindërit e tyre duan që ata të jenë të sigurt.

Ndalimi i ndëshkimit trupor nuk do t'i ndalonte prindërit për ti mbrojtur fizikisht fëmijët e tyre dhe të gjithë e dinë se mbrojtja e dikujt nga rreziku nuk është e njëjtë me të qenurit i dhunshëm ndaj tyre.

# Ka ardhur koha për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve. Fëmijët kanë të drejtën e respektimit dhe mbrojtjes së barabartë nga të gjitha format e dhunës tani!

## **The Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve**

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve promovon ndalimin dhe eliminimin e përgjithshëm të ndëshkimit trupor dhe ofron mbështetje teknike dhe këshilla për të gjitha aspektet e reformës ligjore.

[www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)

[info@endcorporalpunishment.org](mailto:info@endcorporalpunishment.org)

[www.twitter.com/Glencorpun](https://www.twitter.com/Glencorpun)

[www.facebook.com/Glencorporalpunishment](https://www.facebook.com/Glencorporalpunishment)

## **Save the Children Suedi**

Save the Children Suedi avokon për ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset. Në vitin 1979, Save the Children Suedi ka kontribuar që Suedia të bëhet vendi i parë në botë që të ndalojë shprehimisht ndëshkimin trupor. Kjo organizatë po punon në theksimin e kësaj çështjeje për arritjen e një ndalimi ligjor dhe eliminimin e ndëshkimit trupor dhe për ta vënë këtë çështje në agjendën politike në mbarë botën.

[info@rb.se](mailto:info@rb.se)

[www.raddabarnen.se](http://www.raddabarnen.se)

[resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)



Global Initiative to  
**End All Corporal Punishment  
of Children**



**Save the Children**



---

**SWEDEN**

---